



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:235639  
Datë: 14.08.2023  
Numri i dokumentit: 04582148

C-IV-14-6708

*Ankuesi*

**S N**, nga **F K**  
Përfaqësuar nga av **Z Z** nga Prishtina

*Kundër*

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Dritan Hoxha”, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me 14 gusht 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. Ankesa e ankuesit e paraqitur kundër Vendimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit, Nr. PRN093-0566, të datës 25 shtator 2014 refuzohet si e pabazuar.**
- II. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 24 tetor 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër vendimit nr. PRN093-0566, të datës 25 shtator 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilën ka kërkuar që të kompensohet për paga të papaguara në shumë prej 1,575.00 €, për periudhën nga Janari 2005 deri me 14 Gusht 2007 nga N.SH “Gërmia” (në likuidim).

Ankuesi Vendimin e AL e atakon për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave të ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ankuesi pohoi

se N.SH nuk i ka kryere obligimet ndaj tyre si punëtor që nga 01 janar 2005 deri me 14 gusht 2007 në shumë prej 1,575.00 €. Ankuesi pohon se N.SH-ja e ka pranuar borxhin në bazë të shkresës së 25 tetor 2007 me emërtim shkresë për asistencë sociale të papaguara për shkak të ndërprerjes së asistencës sociale të papaguara pa fajin e punëtorit. Ankuesi tutje i referohet nenit 368 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve ku parashkrimi ndërprehet kur debitori e pranon borxhin dhe derisa ndërmarrja është në likuidim të gjitha afatet e parashkrimit ndërprehen dhe procedurat tjera. Nga gjitha arsyet propozon që gjykata ta aprovoj ankesën e tij si të bazuar, apo të njëjtin vendim ta prish dhe çështjen ta kthej në rigjykim. Ankuesi ankesës i ka bashkangjitur kopjen e vendimit të kundërshtuar, kopjen e kërkesës kreditore drejtuar AKP-së dt.25 tetor 2007, dhe kopjen e librezës së punës.

Me 04 korrik 2022, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtje në ankesë, në të cilën i përmbahet qëndrimit se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike, dhe të dispozitave ligjore. E paditura pohoi se ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Më tej e paditura pohoi se kërkesa duhet të ishte paraqitur në gjykatë apo ndonjë organi tjetër kompetent brenda periudhës tre vjeçare, nga momenti kur N.SH-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. E paditura i ka propozuar Gjykatës që ankesën e ankuesit ta refuzoj si të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL-së. Përgjigjes në mbrojtje e paditura i ka bashkangjitur vendimin e AL-së dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të autoritetit të likuidimit.

Me 22 mars 2023, përfaqësuesja e ankuesit parashtrroi përgjigje në mbrojtjen e AKP-së. Përfaqësuesja e ankuesit pohoi se ankuesi ka punuar në N.SH që nga viti 1987 gjer në vitin 1997, dhe prej vitit 1997 ka qene në pushim pa pagese dhe pas luftës është lajmëruar në punë në vitin 2002 në N.SH dhe organizata nuk ka mundur ti siguroje punë dhe e ka caktuar në asistencë sociale, ku punëtorët në asistencë sociale kanë marr nga 50 € në muaj. Tutje pohon se ankuesi ka të drejtë edhe në pagesën e asistencës sociale edhe atë nga 50 € në muaj për periudhën nga 1 janari 2005 deri me 14 korrik, në shumën e tërësishme prej 1,575.00 €. Nga gjitha arsyet propozon që gjykata ta aprovoj kërkesën e tij si të bazuar, dhe ta obligojë AKP që ti kompensojë asistencën sociale në shumë prej 1,575.00 €. Përfaqësuesja e ankuesit përgjigjes në mbrojtje i bashkangjiti: Autorizimin për përfaqësim, kopjen e kërkesës kreditore drejtuar AKP-së dhe kopjen e Librezës së Punës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e ankuesit kundër vendimit të AL Nr. PRN093-0566, refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton si në vijim.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vjen në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se N.SH i ka mbetur borxh kompensimin e pretenduar. Pra, ankuesi nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me periudhën dhe llogaritjen e asistencës sociale të pa paguar ashtu që ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij në tërësi.

Vendimi PRN093-0566, i datës 25 shtator 2014, dhe Libreza e Punës së ankuesit nuk janë prova për ti njohur të drejtën e pretenduar ankuesit. Nga Libreza e Punës vërtetohet se ankuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me 24 nëntor 1997. Ankuesi nuk ka ofruar argumente, as në procedurën e likuidimit pranë AL, me anë të cilave do dëshmohej se vërtetë N.SH i kishte mbetur borxh detyrimin e pretenduar. Po ashtu ankuesi as pranë gjykatës me anë të kërkesës për rishikim të vendimit nuk ka ofruar dëshmi me cilat do të dëshmonin të drejtën në asistencë për periudhën e kërkuar, 1 janar 2005 e gjer me 14 gusht 2007. Pra Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensimin e mjeteve të papaguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si e tillë e ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar